

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtari Ramiz Azizi, me sekretaren juridike-praktikante Blerta Ahmeti, në lëndën penale ndaj të pandehurit Z. P. nga fashti P. komuna P. per shkak të veprës penale “legalizimi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 1 të KPRK-së, e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.873/2016, e dates 10.06.2016, të cilën e përfaqësonte prokurori Shefik Mehmeti, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor dhe publik, më datën 29.12.2016, mori dhe shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari Z. P. nga i ati D. dhe nëna S., e lindur J., i lindur më datë ..., në fshatin P. komuna P. ku tani jeton, i martuar, baba i pese fëmijëve, i papunesuar, ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, s., Shtetas i Republikës së Kosovës, i pagjykuar me pare dhe ndaj tij nuk zhvillohet tjetër procedure penale.

**Është fajtor
Sepse**

Me datën ..., i pandehuri pas përpilimit te dokumentit-librezes se qarkullimit te automjetit nga Republika e Serbise me numër serik ..., ne emër te vetin per automjetin e markës “...”, me numër ... dhe me tabela te regjistrimit ..., i cili me kerte rast ka vene ne lajthim zyrtaret e QKRA-se, ne Mitrovicen e V^leriut, ku me kete dokument edhe legalizon regjistrimin e automjetit, i cilit nga kjo zyre merr tabletat e regjistrimit, ... dhe librezën ... me nr. ..., ne mer te tevin te cilin automjet vazhdon ta legalizoj per vitin 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011 dhe me pastaj kete automjet e transferon dhe e regjistron ne QKRA, ne Gjilan, ku vazhdon ta legalizoj edhe per vitin 2013,2014,2015 dhe 2016, me librezë te qarkullimit CRA nr. ... dhe tabelat e regjistrimit

- me çka ka kryer vepren penale legalizimi i përmbajtjes së rrem nga neni 403 paragrafi 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,21, 49,50, 51, 52,62,69 e 73 të KPRK, si dhe nenit 365,451 e 463 të Kodit të Procedurës Penale (KPPRK), të pandehurit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit Z. P. i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, me kusht që në afatë prej **2 (dy) viteve** pas plotfuqishmërise së këtij aktgjykimi të mos kryej veprë tjetër penale.

Ndaj te akuzuarit gjithashtu është shqiptuar dënimi plotësues konfiskimi i dy librezave te qarkullimit me numër VRD ... dhe CRA ... si dhe tabelat e regjistrimit me numër

Obligohet i akuzuari që në emër te paushallit gjyqësor te paguaj 20 euro si dhe hargjimet e procedurës penale ne shumen e përllogaritur me llogarin perfudndimtare te kësaj gjykate, te gjitha këto ne afatin prej 15 diteve nga dita e plotefuqishmerise se këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit Z. P. nga fshati P. komuna P.për shkak të veprës penale legalizmi i përmbajtjes së rrem nga neni 403 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit Shefik Mehmeti deklaroi :mbetët në tëresi pranë akti akuzues, ku i akuzuari Z. P. e pranoj veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze dhe përgjegjësia penale për të njëjtën dhe kërkon nga gjykata qe të njëjtin ta shpallë fajtor dhe me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh rrethana lehtësuese dhe rënduese me qëllimi që dënimi të jetë proporcional me shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale si dhe ndaj te akuzuarit te shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi i dy librezave te qarkullimit dhe i tabelave te regjistrimit.

I akuzuari Z. P. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi – më vjen keq për rastin që ka ndodhur, është hera e pare që ndeshëm me ligjin, nuk do ta perseris me veprimet qe kam bere pasi qe edhe un isha i mashtruar nga te tjeret, andaj herave te tjera do të kem kujdes, jam i pa punë, i gjendjes së varfer ekonomike dhe kerkoj nga gjykata që teme shqiptoj nje denim me kusht.

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, gjykata konstatoi këtë gjendje faktike:

Se i pandehuri Z. P. nga pakujdesia e ka kryer veprën penal- legalizmi i përmbajtjes së rreme nga neni 403 paragrafi 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivat e këtij aktgjykimi.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka konstatuar dhe e vërtetoi në bazë të pranimit të fajësisë duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues, e shpalli fajtor të pandehurin Z. P. nga P., për shkak të veprës penale, legalizmi i përmbajtjes së rrem nga neni 403 paragrafi 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit Z. P. gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KPK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, ka shprehur keqardhje për kryerjen e kësaj vepre, është i gjendjes se dobët ekonomike ndërsa si rethane rënduese peshën e kryerjes se veprës penale.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit me kusht , është marr duke u bazuar në të gjitha rrethanat e lartcekura, është dënim i drejtë , në harmoni me peshën e veprës penale dhe

shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim me kusht ,do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK-se.

Paushalli gjyqësor dhe hargjimet e procedurës penale është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 4 të KPPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e librezave te qarkullimit dhe tabelave te regjistrimit eshte i bazuar ne nenin 62 dhe 69 te KPRK-se.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.732/16, dt.13.01.2017

Sekretarja juridik-praktikante,
Blerta Ahmeti

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Ramiz Azizi

KËSHILLA JURIDIKE : *Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimin të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.*